

Në
këtë
periodik
të lexoni:

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive
e AMF-së takon misionin e Bankës Botërore
për Programin e Zhvillimit dhe
Qëndrueshmërisë Financiare



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, 2024

Zhvillimet e tregut të titujve të Qeverisë jashtë bursës,
2024

ZHVILLIME TË TJERA

4-6

BOTIME PROFESIONALE

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

7-10

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së takon misionin e Bankës Botërore për Programin e Zhvillimit dhe Qëndrueshmërisë Financiare



Tiranë, 28 janar 2025 - Takim i drejtuesve të AMF-së me ekipin e Bankës Botërore

Ekipi i Bankës Botërore vlerësoi përparimin drejt harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor evropian dhe zbatimin e praktikave më të mira në mbikëqyrje, dhe shprehu gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin me Autoritetin.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, zj. Mimoza Kaçi zhvilloi një takim me ekipin e misionit të Bankës Botërore për Programin e Zhvillimit dhe Qëndrueshmërisë Financiare, të drejtuar nga znj. Rekha Reddy, në rolin e saj të ri si menaxhere e programit.

Në takim u diskutua mbi ecurinë e aktiviteteve në zbatim të programit të Asistencës Teknike, zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, nismat për financat e gjelbra, si edhe bashkëpunimi në kuadër të programit për sigurimet në bujqësi.

Zj. Kaçi e njohu ekipin e Bankës Botërore me zhvillimet kryesore të tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit, si edhe avancimet në drejtim të përafrimit të mëtejshëm me kuadrin ligjor dhe direktivat evropiane, si edhe standardet më të mira mbikëqyrëse. Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive i falënderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen e vazhdueshme, si edhe vuri në dukje disa nga drejtimet kryesore për vijimin e bashkëpunimit.

Ekipi i Bankës Botërore vlerësoi përparimin drejt harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor evropian dhe zbatimin e praktikave më të mira në mbikëqyrje, dhe shprehu gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin me Autoritetin.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2024 kapën vlerën 24,505 milionë lekë, ose 7.02% më shumë se në viti 2023. Gjatë vitit 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,595,687 me një rritje prej 8.84% krahasuar me një vit më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.51% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.45% dhe risigurimi me 0.043%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.55% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.45% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 8,656 milionë lekë, ose 24.38% më shumë se në viti 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2024 kapën vlerën 6,239 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 30.17% krahasuar me vitin 2023.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar - dhjetor 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë vitit 2024 arritën rreth 15,058 milionë lekë, ose 7.71% më shumë se në vitin 2023.

Zhvillimet e tregut të titujve të Qeverisë jashtë bursës, 2024

Të dhënat statistikore të tregut të titujve të Qeverisë jashtë bursës për vitin 2024, flasin për një dominim të transaksioneve “Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 50.10% dhe 36.72% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.


Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë të realizuara jashtë burse për vitin 2024, u dominua në masën 64.17% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 35.83% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).

Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 81.98% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë jashtë burse, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për vitin 2024 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.48% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë jashtë bursës për vitin 2024

Në %



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për vitin 2024 dominohet nga investitorët individualë

ZHVILLIME TË TJERA

AMF – leksion të hapur me studentët e Albanian University



Tiranë, 22 janar 2025 – Leksion i hapur në AMF me studentët e Albanian University

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më 22 janar 2025, një leksion të hapur me studentë të degës së financës të Albanian University. Në leksion u prezantua roli i Autoritetit dhe funksionet e tij në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare jobankare, duke u fokusuar kryesisht në tregun e sigurimeve. Studentëve ju prezantua kuadri ligjor që drejton këto tregje si edhe puna që Autoritetit bën për mbrojtjen dhe informimin e konsumatorit e investitorit. Në leksion u prezantua edhe tërësia e publikimeve statistikore të cilat gjenden në faqen web të Autoritetit dhe që mund të përdoren nga studentët për të realizuar punimet e tyre të diplomës.

Në fund të leksionit, studentët plotësuan edhe një pyetësor online nëpërmjet *google-forms* që mat njohuritë e tyre në tregun e sigurimeve.

Leksioni është pjesë e aktiviteteve që Autoriteti po zhvillon në kuadër të zbatimit të “Strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027”.



Në përfundim të leksionit, studentët plotësuan edhe një pyetësor online, që mat njohuritë e tyre në tregun e sigurimeve.



EIOPA hap procesin e konsultimeve për tre dokumente konsultativë mbi rreziqet nga katastrofat natyrore, masat parandaluese dhe ndërgjegjësuere, biodiversitetin dhe qëndrueshmërinë

Më 11 shkurt 2025 EIOPA hapi një diskutim të gjerë publik mbi tre dokumente lidhur me rreziqet nga katastrofat natyrore, masat parandaluese e ndërgjegjësuere, biodiversitetin dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve.

Tri temat në diskutim lidhen me:

- Mekanizmat për të rritur ndërgjegjësimin mbi katastrofat natyrore dhe masat parandaluese;
- Biodiversitetin;
- Planet për qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve.

Dokumentet Konsultativë që ka publikuar EIOPA për konsultim janë:

- Konsultimi mbi një plan për mekanizmat ndërgjegjësuere mbi rreziqet e katastrofave natyrore dhe masat parandaluese, https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-blueprint-awareness-tool-natural-catastrophe-risks-and-prevention-measures_en?prefLang=sk
- Konsultimi mbi një raport mbi menaxhimin e rrezikut të biodiversitetit nga siguruesit, https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-report-biodiversity-risk-management-insurers-solvency-ii-review_en
- Konsultimi mbi propozimin për Standardet Rregullative Teknike për menaxhimin e rreziqeve të qëndrueshmërisë duke përfshirë planet e rrezikut të qëndrueshmërisë, https://www.eiopa.europa.eu/consultations/consultation-proposal-regulatory-technical-standards-management-sustainability-risks-including_en

EIOPA fton palët e interesuara të japin komentet e tyre për këto Dokumente Konsultative edhe duke iu përgjigjur pyetjeve nëpërmjet një anketimi online.

EIOPA hap konsultim publik mbi tre dokumente lidhur me rreziqet nga katastrofat natyrore

Këshilli i Evropës: Ndryshimi i klimës mund ta shtyjë kontinentin drejt një krize të mundshme sigurimesh

www.xprimm.com

Raporti i Këshillit të Evropës i publikuar së fundmi në *Forward look 2025 - Time for leadership* thekson se si ndryshimi i klimës po ndikon gjerësisht në industrinë e sigurimeve, ku rritja e kostove dhe zgjerimi i boshllëqeve të mbulimit rrezikojnë ta shtyjë kontinentin drejt një krize të mundshme sigurimesh.

“Në disa rajone, kërcënimi që asetet të bëhen të pasigurueshme është afruar, duke i lënë qeveritë dhe qytetarët gjithnjë e më të prekshëm ndaj rreziqeve financiare”, thuhet në raport. Pikat kryesore përfshijnë:

1. Rritja e kostove të fatkeqësive natyrore: Ekstremet e lidhura me klimën i kanë kushtuar Bashkimit Evropian 738 miliardë euro gjatë katër dekadave të fundit, me 162 miliardë euro të shkaktuara vetëm në vitet 2021- 2023. Siguruesit përballen me sfida të rëndësishme në mbulimin e këtyre humbjeve në rritje.
2. Rreziqet e krizës së sigurimeve: Rritja e kostove dhe zgjerimi i boshllëqeve të mbulimit po tensionojnë tregjet e sigurimeve të Evropës, me disa rajone që përballen me mundësinë që asetet të bëhen të pasigurueshme, duke i lënë qeveritë dhe individët të ekspozuar financiarisht.
3. Rritja e Pikave Klimatike: Ngjarjet si destabilizimi i shtresave të akullit të Grenlandës dhe moti ekstrem evropian nënvizojnë urgjencën për strategjitë e përshtatjes klimatike, krahas edhe përpjekjeve zbutëse të këtyre ngjarjeve.
4. Nevojita e bashkëpunimit global: Ndërsa BE-ja kontribuon vetëm me 6.7% të emetimeve globale, veprimi kolektiv ndërkombëtar është kritik. Roli i BE-së si një lider për klimën sfidohet nga angazhimet e pabarabarta globale, veçanërisht me tërheqjen e mundshme të rregulloreve mjedisore nga SHBA.
5. Përshtatja si prioritet: Industria e sigurimeve duhet të kalojë nga menaxhimi reagues i krizës në ndërtimin proaktiv të elasticitetit, me iniciativa si COP30 e ardhshme që pritet të nxisë planet kombëtare të përshtatjes.

Raporti nënvizon rolin kryesor të siguruesve në adresimin e rreziqeve klimatike, ndërkohë që bën thirrje për ndryshime sistematike për të mbrojtur ekonominë dhe komunitetet nga kërcënimet mjedisore në rritje.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave që Xprimm i referohet publikimeve të specializuara të sigurimeve “Gazeta Ubezpieczeniowa” në Poloni, çmimet e MTPL-së vitin e kaluar u rritën me 25% në krahasim me vitin 2023. Ekspertët besojnë se shoferët do të përballen me rritje të mëtejshme në vitin 2025.

Raporti “Renditja – RanKING” – tregu i sigurimeve motorike dhe çmimet” i përgatitur nga Rankomat tregon se çmimi mesatar i MTPL-së në vitin 2024 ishte 650 PLN (afërsisht 152 euro). Ekspertët theksojnë se trendi aktual i çmimeve prej 25% i ngjan situatës së tetë viteve më parë. Midis 2016 dhe 2017, primet u rritën me 24%, por kjo nuk ishte aq e shpejtë sa vitin e kaluar. Për pesë vitet e ardhshme, çmimi mesatar ka rënë sistematikisht - nga 779 PLN në 2017 në 505 PLN në 2022. Pas një rritjeje minimale prej 3% në 2023, ai tani arrin 650 PLN, që është ende 129 PLN më pak se në vitin viti rekord i 2017. Në tremujorin e katërt 2024, çmimi mesatar ishte PLN 694, që ishte më i ulëti që nga fillimi i vitit 2023, më pas filloi të rritet sistematikisht.

“Pas një periudhe të gjatë rënieje të çmimeve të MTPL-së dhe një rritjeje të lehtë përgjatë vitit 2023, kemi një rikthim të mprehtë në rritje. Në vitin 2024, të gjithë tremujorët përfunduan me rritje prej të paktën 2.1%. Kulmi i rritjeve ka qenë në tremujorin e dytë të vitit 2024, kur kemi vërejtur një rritje prej 11.1% krahasuar me tremujorin paraardhës. Në vitin 2025, gjobat për mungesë sigurimi të detyrueshëm do të rriten sërish, por çmimet e MTPL nuk duhet domosdoshmërisht të rriten, gjë që varet nga disa faktorë”, tha për Xprimm Bartosz Niewiadomski, President i Bordit Drejtues të Rankomat.

Raporti “Renditja – RanKING” bazohet në të dhënat e mbledhura nga Rankomat për periudhën nga 1 janari deri më 27 dhjetor 2024 dhe produkteve MTPL që ofrohen nga 16 kompanitë më të mëdha në tregun vendas.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, IAC, tregu i sigurimeve të Qipros, në fund të shtatorit 2024, arriti në 936.3 milionë euro, duke u rritur me 7.6% në terma vjetore.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rrit me 9.7% në terma vjetorë duke arritur 486.6 milionë euro, ndërsa segmenti i Jo-Jetës raportoi një rritje prej 5.45%, duke arritur në 449.7 milionë euro.

Po kështu, u rrit edhe shuma e dëmeve të paguara në sigurimin e Jetës, duke arritur në 208.85 milionë euro, me rritje vjetore 12%, ndërsa dëmet e shkaktuara për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 3.14% dhe arritën në 196.8 milionë.

RUMANI

www.xprimm.com

Vëllimi i primeve të shkruara bruto gjatë 9-mujorit 2024 për siguruesit aktivë në tregun rumun arriti në vlerën e 3.39 miliardë euro. Kjo shifër është 11.45% më shumë në krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ky total, siguruesit vendas përbënin 2.88 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër prej 513 milionë euro u gjenerua nga degët e siguruesve të BE-së që operojnë në sistemet FOS/FOE.

Sigurimi i Jetës pati një rritje të primeve me 13.3% duke arritur në 642 milionë euro. Kontributin më i lartë në këtë rritje, në vlerë absolute, erdhi nga linja e anuiteteve dhe sigurimet suplementare.

Sigurimet e Jo-Jetës realizuan një vlerë prej 2.75 miliardë euro, ose 11% më shumë krahasuar me 9-mujorin e vitit të kaluar. Kontributi i degëve të huaja të shoqërive të sigurimit që veprojnë në Rumani në sigurimet e Jo-Jetës u rrit me gati 3 pikë përqindjeje nga 12% të vëllimit të primeve në rreth 15% në fund të 9-mujorit 2024.

SERBIA

www.xprimm.com

Në fund të 9-mujorit 2024, tregu i sigurimeve të Serbisë realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 132.57 miliardë RSD, ose rreth 1.13 miliardë euro, Kjo shifër shpreh një rritje me 14.67% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pjesën më të madhe të primeve e zinin ato të sigurimeve të Jo-Jetës, me 109.13 miliardë RSD dhe segmenti i sigurimit të Jetës zinte 15.4 miliardë RSD.

Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 13.93% në vit duke arritur në 59.78 miliardë RSD ose rreth 510.6 milionë euro, nga e cila, pjesa më e madhe prej 44.78 miliardë RSD, ishte e lidhur me sigurimet e Jo-Jetës.

Në fund të shtatorit 2024, në treg vepronin 16 kompani sigurimesh.

SLLOVAKIA

www.xprimm.com

Sipas statistikave 9-mujore të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, NBS, gjatë 9-tremujorit të 2024, tregu sllovak i sigurimeve arriti një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 1.56 miliardë euro, ose 6.96% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Për të njëjtën periudhë, sigurimet e Jetës u rritën me 3.5% në vit duke arritur në 578.7 milionë euro, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës përbënin 982.85 milionë euro (ose 62.94% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto).

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas u ul me 23.66% në terma vjetorë, duke arritur në 877.5 milionë euro, nga të cilat 391.8 milionë euro lidhen me dëmet në sigurimet e Jetës, pjesa e mbetur prej 485.7 milionë euro llogaritet nga dëmet e paguara për klasat e tjera të Jo-Jetës.



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al